



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO  
KOMUNA E OBILIQIT  
OPŠTINA OBILIĆ - MUNICIPALITY OF OBILIC



## ZYRA E KRYETARIT

Duke u bazuar në nenin 68 të ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, dhe paragrafin 4 të nenit 17 të Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr. 06/2018 për Standardet Minimale të Konsultimit Publik në Komuna, paraqet këtë:

### RAPORT

(Draft-Matrica Plani Lokal i Veprimit për Barazinë Gjinore 2024-2026)

Kryetari i Komunës së Obiliqit, Xhafer Gashi, nëpërmjet Zyrës për Barazi Gjinore me datë 13.12.2023 ka mbajtur diskutimin publik për dokumentin, “**Draft Plani Lokal i Veprimit për Barazinë Gjinore 2024-2026**” diskutimi është mbajtur në Sallën e Kuvendit Komunal, nga ora 11:00.

Gjatë diskutimit ishin prezent, Kryesuesja e Kuvendit Komunal, Drejtorë të Komunës, përfaqësues të KFOR-it, ekipi për konsultime publike, përfaqësues të OJQ-ve dhe qytetarë.

Të pranishëm në këtë diskutim kanë qenë gjithsej 35 qytetarë, prej tyre 35 gra.

Prezantimi i Draft-Matrices u bë nga zyrtarja për Barazi Gjinore, znj.Ganimete Aliu, e cila fillimisht i falënderoi pjesëmarrësit, dhe të gjithë ata që kanë kontribuar në hartimin e Draft-Matricës, po ashtu falënderoi UN Women si dhe Bashkimin Evropian për financimin në hartimin e dokumentit, dhe ka vlerësuar se barazia gjinore është vlerë themelore për zhvillimin demokratik të një vendi, dhe i njofton në pika të shkurta për përmbajtjen e këtij Plani.

Pas prezantimit kemi pranuar tri (3) kërkesa për informacion.

- **Magribe Salihaj:** Kryetare e Aktivit të Gruas, faleminderit për të gjitha këto informat, kam disa kërkesa kam afër 6 muaj me aktivin e gruas, ku jemi diku rreth 90 gra në shtëpinë e pensionistëve e cila nuk po na i përmbushë kërkesat tona ju e dini se si është dhe është pak e vogël për ne, një kërkesë tjetër kam plani i asaj shtëpije ku jemi është një plan shumë i mirë dhe ka mundësi të ndërtohet edhe një kat tjetër për me kriju hapsir, ne

kemi një ditë të javës ditën e enjete ku ne bashkohemi, kërkesa tjera kam që shtëpi të pleqve nuk ka në komunën e Obiliqit andaj me mundësi zgjerimi për shtëpi të pleqve dhe hapsirë të mundshme. Ndërsa pensionistët nuk kanë transport, me grat që punoj janë prej fshatrave të cilat koston e udhëtimit e kanë nga 2-3 euro në ditë. Kam shumë kërkesa dhe janë madhore mirëpo kryesorja është hapsira të zgjerohet me një katë tjetër na duhet një vend dhe mundësia më e mirë është që të krijohet hapsirë.

- **Xhemile Krasniqi:** Kërkesa ime për grat është për bashkëpunim mes vete dhe një bashkëpunim me ide të reja dhe të jemi si OJQ për ushqime tradicionale.
- **Jalldyze Maloku:** edhe salla është shumë e vogël dhe çdo ditë po shtohet numri i grave dhe shumica shpesh her qëndrojmë edhe në kam.

- ✓ **Vlora Mjekiqi:** Kërkesat janë me vend dhe kërkesat e juaja nuk janë në cilësi me strategjinë për barazi mirëpo këto kërkesa do të mirren parasysh këto kërkesa nuk janë paraqit kur është mbajtur debati publik për buxhetin 2024, kërkesat e juaja do të mirren parasysh nga Kryetari i Komunës.

Transporti do të sigurohet nga komuna e Obiliqit nga Trafiku Urban dhe kanë një marrëveshje se si do të sigurohet dhe se si të liroheni nga pagesa e transportit ju si pensionistë. Uroj të ju kemi me shëndet dhe jetë të gjatë dhe nuk e shohim si problem për pagesën, ju kisha lutur që të jeni prezentë në diskutime publike për buxhet dhe të paraqitni kërkesat tuaja.

Problemet e grave si çdo komunë bashkarisht i kemi diskutu dhe jemi si komuna me e zhvilluar në regjion, kryetari veç pagun shpenzimet e udhëtimit për të gjithë nxënësit që udhëtojnë mbi 3km dhe nuk është aspak telashe të subvencionohet edhe udhëtimi i pensionistëve.

Zyrtarja për Barazi Gjimore falënderoi Kryesuesen e kuvendit komunal për përgjigjet në pyetjet e zonjave, dhe i falënderoi të gjitha të pranishmet për prezencën në këtë takim dhe për kontributin e tyre.

Komente të tjera nuk kemi pranuar as në formën me shkrim, diskutimi publik ka përfunduar në ora 11:40.


Pjesë përbërëse e këtij raporti janë:

1. Procesverbali dhe
2. Lista e Pjesëmarrësve.

Obiliq  
10.01.2024

Zyrtare përgjegjëse për konsultime publike

Festina Preniqi





---

ZYRA PËR BARAZI GJINORE

PROCESVERBAL

**PROCESVERBAL I MBAJTUR ME DATËN 13.12.2023 "Plani Lokal i Veprimit për Barazinë Gjinore 2024-2026"**

Takimi filloi në orën 11:00

Në takim ishin të pranishëm zyrtarë e Barazisë Gjinore z.Ganimete Aliu, Kryesuesja e Kuvendit z. Vlora Mjekiqi - Kabashi, drejtorë të drejtorive, zyrtarë komunal, grupi punues për konsultime publike, qytetarë e përfaqësues të OJQ-ve. Fjalën hyrëse dhe përshëndetëse për gratë prezentë nga Ganimete Aliu.

Para se të fillojë takimi një fjalë rasti nga Kryesuesja e Kuvendit Komunal, përshëndetje për zonjat dhe për përfaqësuesit nga KFOR-I, jemi sot këtu për planin për barazi gjinore, ne një takim që kisha në Prizren, në atë takim ndihesha e privileguara se Komuna jonë prin si komunë në të gjitha aspektet, komuna jonë është e para gjithashtu këtu kemi Flaka Hashani që e bënë raportin për Buxhetimin me Pjesëmarrje.

Po fillojmë se çka është ky dokument që do e paraqesim sot.

**Ganimete Aliu** e merr fjalën:

Plani Lokal i Veprimit për Barazinë Gjinore (PLVBGJ) 2024 – 2026 po përgatitet nga Komuna Obiliq, si mjeti kryesor i zbatimit të angazhimeve publike për barazinë gjinore, të reflektuara në: Kushtetutën e Republikës së Kosovës. Instrumentet kryesore ndërkombëtare për barazinë gjinore dhe fuqizimin e grave, drejtpërsëdrejti të aplikueshme në legjislacionin e vendit. Ligjin për Barazi Gjinore Nr. 05/L-020, si dhe tërësinë e ligjeve të vendit të fokusuar tek barazia, mos diskriminimi dhe fuqizimi i grave. Programin e Kosovës për Barazi Gjinore 2020 – 2024, si dhe tërësinë e kornizës zhvillimore vendore (programe e strategji) për promovimin e barazisë gjinore dhe fuqizimin e grave. Instrumente dhe mjete të BE-së të fokusuar tek barazia gjinore, si pjesë e procesit të integritimit, veçanërisht ato që përmbajnë veprimet që duhet të ndërmerren në nivelin lokal – siç është edhe Karta Evropiane për Barazi të Grave dhe Burrave në Jetën Lokale, etj.

Çfarë vlere ka për komunën ky dokument?

Plani Lokal i Veprimit për Barazinë Gjinore, është: një mjet praktik i lokalizimit të dokumenteve të rëndësishëm kombëtarë, por edhe ndërkombëtarë në lidhje me barazinë gjinore (veçanërisht instrumentet drejtpërsëdrejti të aplikueshme në legjislacionin e vendit). Një dokument i hartuar përmes një procesi gjithëpërfshirës, me hapa të mirë përcaktuar, e në përmbajtje të të cilit reflektohen arritjet dhe sfidat e ndeshura ndër vite nga Komuna, në përparimin drejt barazisë gjinore. Një pasqyrim i qartë i roleve dhe përgjegjësi të domosdoshme për t'u përmbushur brenda Komunës, si dhe ndërmjet Komunës e institucioneve lokale apo organizatave të shoqërisë civile e ato ndërkombëtare, me qëllim zbatimin në

praktikë të parimit të barazisë për të gjitha/gjithë gratë, burrat, të rejat, të rinjtë, vajzat dhe djemtë, në të gjithë diversitetin e tyre, në Komunën e Obiliqit.

Barazia gjinore nënkupton që të gjitha qeniet njerëzore, si gratë dhe burrat, janë të lirë të zhvillojnë aftësitë e tyre personale dhe të bëjnë zgjedhje pa pasur kufizime të vëna nga stereotipat gjinore, rolet e ngurta gjinore, apo paragjykimet. Barazi gjinore do të thotë që sjelljet, aspiratat dhe nevojat e ndryshme të grave dhe burrave merren parasysh, vlerësohen dhe favorizohen në mënyrë të barabartë. Barazi gjinore nuk do të thotë që gratë dhe burrat duhet të bëhen të njëjtë, por që të drejtat, përgjegjësitë dhe mundësitë e tyre nuk do të varen nga fakti nëse kanë lindur femra apo meshkuj. Drejtësia gjinore nënkupton që gratë dhe burrat trajtohen në mënyrë të drejtë, sipas nevojave të tyre përkatëse. Kjo mund të përfshijë trajtim të barabartë, ose trajtim që është i ndryshëm, por që konsiderohet i barasvlershëm për sa i përket të drejtave, përfitimeve, detyrimeve dhe mundësive. Në kontekstin e zhvillimit, synimet për drejtësi gjinore shpesh kërkojnë përfshirjen e masave që kompensojnë për diavantazhet historike dhe sociale të grave.

Njësitë e Vetëqeverisjes Lokale janë sfera të qeverisjes që gjenden më pranë njerëzve, ndaj dhe përfaqësojnë nivelet që kanë më tepër mundësi të luftojnë vazhdimësinë dhe riprodhimin e pabarazive, si dhe të avancojnë për një shoqëri me të vërtetë të barabartë. Zbatimi dhe promovimi i të drejtës së barazisë duhet të qëndrojë në zemër të konceptit të vetëqeverisjes lokale. Pavarësisht përpjekjeve të bëra apo që po vazhdojnë të bëhen ndër vite në këtë drejtim, si dhe plotësimin e harmonizimit të kornizës ligjore dhe të politikave lokale me ato kombëtare e ndërkombëtare, duhet të pranojmë që realiteti ende flet për barazi dhe drejtësi gjinore të munguara në praktikë. Nëse duam të krijojmë një shoqëri të mbështetur në barazi, është thelbësore që organet e vetëqeverisjes lokale të marrin parasysh plotësisht integrimin gjinor në politikën, organizimin dhe praktikën e tyre të punës. Barazia e vërtetë ndërmjet grave dhe burrave, të rejave dhe të rinjve, vajzave dhe djemve, është çelësi për suksesin ekonomik dhe shoqëror.

Komuna e Obiliqit ka ndjekur një metodologji gjithëpërfshirëse, përmes këtyre hapave: Ngritja e Grupit Punues për përgatitjen e këtij plani, me kërkesë të Kryetarit të Komunës. Analiza dhe vlerësimi i situatës përmes të dhënave dhe informacionit ekzistues. Përcaktimi i fushave kryesore të ndërhyrjes, të domosdoshme për t'u përfshirë në matricën e PLVBGJ 2024-2026. Konsultimet paraprake brenda komunës dhe hartimi i draft matricës së PLVBGJ.

Një rol të rëndësishëm në hartimin e këtij dokumenti ka patur edhe mbështetja nga UN Women Kosovë, përmes projektit "Gender Equality Facility" që financohet nga fonde të Bashkimit Evropian.

**ÇFARË PARASHIKOHET NË KËTË PLAN?** Masat dhe veprimet e parashikuara në PLVBGJ synojnë zbatimin e pesë objektivave strategjike, të cilët ndahen më pas në tetë objektiva specifike: **PROMOVIMI I BARAZISË GJINORE DHE FUQIZIMI I GRAVE, TË REJAVE DHE VAJZAVE NË TË GJITHË DIVERSITETIN E TYRE.** Zbatimi në praktikë i integritimit gjinor dhe buxhetimit të përgjegjshëm gjinor, si mjete për përparimin e Komunës drejt barazisë gjinore. Krijimi i kushteve që mundësojnë pjesëmarrje dhe lidhshmëri të barabartë në vendimmarrje të grave, burrave, të rejave, të rinjve, vajzave e djemve, në të gjithë diversitetin e tyre. **PROMOVIMI I TË DREJTAVE PËR ARSIM CILËSOR, KULTURË E SPORT, PËR GRATË, BURRAT, TË REJAT, TË RINJTË, VAJZAT DHE DJEMTË, NË TË GJITHË DIVERSITETIN E TYRE** Ofrimi i mundësive të barabarta për arsim cilësor e të mësuarit gjatë gjithë jetës, për vajzat, të rejat dhe gratë, si dhe djemtë, të rinjtë e burrat e Komunës, në të gjithë diversitetin e tyre. Promovimi i modeleve të suksesshme të grave, të rejave dhe vajzave, në të gjithë diversitetin e tyre, që investojnë dhe marrin pjesë aktivisht në art, kulturë dhe sport. Masat dhe veprimet e parashikuara në PLVBGJ synojnë zbatimin e pesë objektivave strategjike, të cilët ndahen më pas në tetë objektiva specifike:

Promovimi i barazisë gjinore dhe fuqizimi i grave, të rejave dhe vajzave në të gjithë diversitetin e tyre. Zbatimi në praktikë i integritit gjinor dhe buxhetit të përgjegjshëm gjinor, si mjete për përparimin e Komunës drejt barazisë gjinore. Krijimi i kushteve që mundësojnë pjesëmarrje dhe leadership të barabartë në vendimmarrje të grave, burrave, të rejave, të rinjve, vajzave e djemve, në të gjithë diversitetin e tyre. Promovimi i të drejtave për arsim cilësor, kulturë e sport, për gratë, burrat, të reja, të rinjtë, vajzat dhe djemtë, në të gjithë diversitetin e tyre. Ofrimi i mundësive të barabarta për arsim cilësor e të mësuarit gjatë gjithë jetës, për vajzat, të reja dhe gratë, si dhe djemtë, të rinjtë e burrat e Komunës, në të gjithë diversitetin e tyre. Promovimi i modeleve të suksesshme të grave, të rejave dhe vajzave, në të gjithë diversitetin e tyre, që investojnë dhe marrin pjesë aktivisht në art, kulturë dhe sport çfarë parashikohet në këtë plan? (vazhdon). Për përmbushjen e objektivave specifike dhe përparimin drejt objektivave strategjikë janë parashikuar rreth nënlëdhjet e një aktivitete, të cilat shtrihen në një periudhë kohore tre vjeçare. Në PLVBGJ gjithashtu janë përcaktuar tregues në nivel të aktiviteteve, tregues në nivel të objektivave specifike, si dhe rezultate të pritshme në nivel të objektivave specifike dhe në nivel të objektivave strategjike. Është bërë një ndarje e qartë e institucioneve përgjegjëse dhe atyre partnere e bashkëpunëtoresh në zbatim, si dhe është përcaktuar edhe burimi i financimit, me qëllim që, për aktivitete të cilat ende nuk kanë një burim financiar të siguruar, të mund të llobohet me donatorët dhe partnerët e bashkëpunëtorët për të mundësuar gjetjen e fondeve dhe zbatimin e këtyre aktiviteteve dhe PLVBGJ në tërësi. Monitorimi i zbatimit të PLVBGJ është përcaktuar gjithashtu qartësisht, i ndarë nga raportimi i rregullt e periodik.

Disa masa të rëndësishme të propozuara (të gjitha masat dhe aktivitetet janë të paraqitura në dokumentin e postuar në faqen e komunës):

Sesione informuese dhe fushata vetëdijesuese mbi të drejtat e grave në vendimmarrje, arsimim, formim profesional, punësim, pronësi, shëndetësi, bujqësi, etj., si dhe për mbrojtje nga dhuna me bazë gjinore, diskriminimi gjinor, i shumëfishtë e i ndërthurur, etj.

Zbatimi i Ligjit për Barazi Gjinore dhe masave të veçanta (afirmative) në të gjithë mbështetjet që ofron komuna dhe institucionet përgjegjëse për grante, subvencione, ndarje çmimesh, bursash, etj.

Trajnime dhe fuqizim të kapaciteteve të zyrtareve/zyrtarëve për integrimin gjinor, buxhetimin e përgjegjshëm gjinor dhe zbatimin në praktikë të tyre.

Mbështetja dhe promovimi i modeleve pozitive të vajzave, të rejave dhe grave, në të gjithë diversitetin e tyre, për kontribute në fusha të caktuara.

Edukimi dhe vetëdijësimi për të luftuar pabarazitë gjinore dhe diskriminimin gjinor që ushqehen nga stereotipet gjinore dhe praktikat e dëmshme (martesat e hershme, ndarja gjinore e profesioneve, sporteve, edukimi mbi të drejtat dhe shëndetin seksual e riprodhues, etj.), si dhe shumë aktivitete të tjera, përfshirë dhe ato me fokus tek mjedisi dhe lidhja e tij me çështjet gjinore.

Me përfundimin e dëgjimit publik:

Do të përmirësohet draft matrica e PLVBGJ bazuar në të gjithë komentet dhe sugjerimet tuaja.

Do të përfundohet kostimi i matricës së PLVBGJ.

Do të plotësohet përshkrimi narrativ i planit (pra ku të shpjegohen qëllimi, objektivat, masat dhe veprimet e parashikuara, zbatimi dhe monitorimi i tyre).

Do të ndiqen të gjithë hapat e detyrueshëm, sipas legjislacionit në fuqi për të kaluar këtë dokument për miratim në Kuvendin Komunal.

Pas miratimit nga Kuvendi Komunal dhe dhënies së miratimit edhe nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, do të fillojë puna për zbatimin e tij.

Komuna do të mbajë vazhdimisht të informuar banoret dhe banorët mbi arritjet në lidhje me zbatimin e këtij PLVBGJ, dhe do të bashkëpunojë me të gjitha institucionet lokale, organizatat e shoqërisë civile dhe ato ndërkombëtare, sipas nevojës e masave të parashikuara për përparimin drejt barazisë gjinore.

Ju lutemi, duke u bazuar në këtë prezantim të përmbledhur, si dhe në përmbajtjen e draft matricës me të cilën jeni njohur përmes postimit në faqen zyrtare të Komunës, të ndani me ne: mendimet, vërejtjet, sugjerimet, propozimet për ndryshim – plotësim apo shtim të aktiviteteve të reja, si dhe çdo koment apo ide

tjetër që mund të keni, për të përmirësuar këtë dokument të rëndësishëm dhe për ta finalizuar atë.

**Magribe Salihaj:** Kryetare e Aktivit të Gruas, faleminderit për të gjitha këto informata, kam disa kërkesa kam afër 6 muaj me aktivin e gruas, ku jemi diku rreth 90 gra në shtëpinë e pensionistëve e cila nuk po na i përmbushë kërkesat tona ju e dini se si është dhe është pak e vogël për ne, një kërkesë tjetër kam plani i asaj shtëpie ku jemi është një plan shumë i mirë dhe ka mundësi të ndërtohet edhe një kat tjetër për me kriju hapësira, ne kemi një ditë të javës ditën e enjete ku ne bashkohemi, kërkesa tjera kam që shtëpi të pleqve nuk ka në komunën e Obiliqit andaj me mundësi zgjerimi për shtëpi të pleqve dhe hapsir të mundeshme. Ndërsa pensionistët nuk kanë transport, me grat që punoj janë prej fshatrave të cilat koston e udhëtimit e kanë nga 2-3 euro në ditë. Kam shumë kërkesa dhe janë madhore mirëpo kryesorja është hapsira të zgjerohet me një katë tjetër na duhet një vend dhe mundësija më e mirë është që të krijohet hapsir.

**Xhemile Krasniqi:** Kërkesa ime për grat është për bashkëpunim mes vete dhe një bashkëpunim me ide të reja dhe të jemi si OJQ për ushqime tradicionale.

**Jalldyze Maloku:** edhe salla është shumë e vogël dhe çdo ditë po shtohet numri i grave dhe shumica shpesh her qëndrojmë edhe në kam.

**Vlora Mjekiqi :** Kërkesat janë me vend dhe kërkesat e juaja nuk janë në cilësi me strategjinë për barazi mirëpo këto kërkesa do të merren parasysh këto kërkesa nuk janë paraqit aty kur është mbajtur debati publik për buxhetin 2024, kërkesat e juaja do të mirren parasysh nga Kryetari i Komunës.

Transporti do të sigurohet nga komuna e Obiliqit nga Trafiku Urban dhe kanë një marrëveshje se si do të sigurohet dhe se si të liroheni nga pagesa e pensionistëve. Uroj të ju kemi me shëndet dhe jetë të gjatë dhe nuk e shohim si problem për pagesën, ju kisha lut që të jeni prezentë në diskutime publike për buxhet dhe ti paraqitni kërkesat tuaja.

Këto kërkesa nuk i shoh si të pa realizueshme dhe kërkoj falje që nuk e përshëndeta ekspertin nga Women for Women.

Problemet e grave si çdo komunë bashkarisht i kemi diskutuar dhe jemi si komuna me e zhvilluar në regjion, kryetari veç paguan shpenzimet e udhëtimit për të gjithë nxënësit që udhëtojnë mbi 3km dhe nuk është aspak telashe për subvencionohet edhe udhëtimi I pensionistëve.

Zyrtarja për Barazi Gjimore falënderoi Kryesuesen e kuvendit komunal për përgjigjet në pyetjet e zonjave, dhe I falënderoi të gjitha të pranishmet në këtë takim.

Takimi përfundoi në ora, 11:40, me gjithsej 35 pjesëmarrës.

Procesmbajtëse: Majlinda Kutllovci



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO  
KOMUNA E OBILIÇIT  
OPŠTINA OBILIĆ - MUNICIPALITY OF OBILIĆ



LISTA E PJESËMARRËSVE

Debat Publik "Plani Lokal i Veprimt për Barazinë Gjinore 2024-2026"

Vendi: Salla e Kuvendit Komunal

Filloi në ora: 11:00

Data: 13.12.2023

| Nr. | Emri dhe Mbiemri  | Vendbanimi | Telefoni    | E-mail                | Nënshkrimi        |
|-----|-------------------|------------|-------------|-----------------------|-------------------|
| 1.  | Shemrij Bajrova   | Raukovc    | 049-322-903 |                       | Shemrij Bajrova   |
| 2.  | Sadije Gimolli    | BAKSHI     | 044-102-308 |                       | Sadije Gimolli    |
| 3.  | ELFETE KURTESHI   | OBILIĆ     | 099-808-408 |                       | Elfete Kurteshi   |
| 4.  | Jellobyqe Mollek  | 13.011.203 | June Lohi   |                       | Jellobyqe Mollek  |
| 5.  | Leonora Morina    | Obilica    | 044-401-825 |                       | Leonora Morina    |
| 6.  | Albina Pestelica  | OBILIĆ     | 045-815-588 |                       | Albina Pestelica  |
| 7.  | Iskender Hasani   | Mazgit     | 045-586-081 |                       | Iskender Hasani   |
| 8.  | MEDINA SVIECA     | MAZGIT     | 049-528-997 |                       | Medina Svieca     |
| 9.  | Diamanta Teshelli | Mazgit     | 068-118-156 |                       | Diamanta Teshelli |
| 10. | Hamife Berisha    | Mazgit     | 049-804-301 |                       | Hamife Berisha    |
| 11. | Rejfe Burmaku     | Mazgit     | 045-576-234 |                       | Rejfe Burmaku     |
| 12. | Fejmeze Teshelli  | Mazgit     | 045-684-909 |                       | Fejmeze Teshelli  |
| 13. | Shemije Ibrahimaj | Mazgit     | 066138-338  | shopata.miriam@com    | Shemije Ibrahimaj |
| 14. | Dajina Aliu       | Millosheni | 094925717   | dajina.aliu@gmail.com | Dajina Aliu       |

| Nr. | Emri dhe Mbiemri    | Vendbanimi | Telefoni               | E-mail                             | Nënskrimi     |
|-----|---------------------|------------|------------------------|------------------------------------|---------------|
| 15. | Fotem Beba          | Rolley     | 043 586 602            |                                    | <del>FR</del> |
| 16. | KFOR JMT KZ OSILIQ  |            | <del>043 586 602</del> | L.M.T-OSILIC.SWISSNET@vfp.admin.ch | OSILIC        |
| 17. | NANA SPASIO         | Plewetina  | 049 831 247            |                                    | OSILIC        |
| 18. | ZONCA SPASIO        | Plewetina  | 049 831 205            |                                    | S.C.          |
| 19. | Shpresa Haxhani     | Obilic     | 045-201-862            |                                    | <del>FR</del> |
| 20. | Shpirtorije Haxhani | Obilic     | 044 759 285            |                                    | <del>FR</del> |
| 21. | Fabrizio Miteama    | Obilic     | 045 421 140            |                                    | FR            |
| 22. | Monisha Kocaj       | Sharqeni   | + 355 68618810         | monisha.kocaj@gmail.com            | FR            |
| 23. | Alta Haxhani        | Obilic     | 044/404-124            |                                    | FR            |
| 24. | Redife Kreshqi      | Maçigjt    | 064-587,039            |                                    | FR            |
| 25. | MYSLEFRIJE ELSHANI  | OBILIC     | 044-881-630            |                                    | FR            |
| 26. | HYKLA - REXHA       | OBILIC     | 043-725 558            |                                    | FR            |
| 27. | Melije - Ramadan    | OBILIC     | 044-521-241            |                                    | FR            |
| 28. | Marije Sehic        | Prishtine  | 044-205-438            | marije.sehic@i.com                 | FR            |
| 29. | Gerde Behar         | Obilic     | 044.399.538            |                                    | FR            |
| 30. | Hada Behar          | Obilic     | 045 795 056            |                                    | Hollandia     |
| 31. | Linda Behar         | Priznic    | 046 200 204            |                                    | FR            |
| 32. | Vlora Mikabardhi    | Obilic     | 045-165-070            | Vlora.mikabardhi@rks.gov.al        | FR            |
| 33. | Martina Sullowaj    | Obilic     | 044-40532              | martina.sullowaj@rks.gov.al        | FR            |
| 34. | Gjergjina Sullowaj  | Obilic     |                        |                                    | FR            |
| 35. | Festina Preraj      | Obilic     | 045 694 916            |                                    | FR            |
| 36. |                     |            |                        |                                    |               |
| 37. |                     |            |                        |                                    |               |
| 38. |                     |            |                        |                                    |               |
| 39. |                     |            |                        |                                    |               |
| 40. |                     |            |                        |                                    |               |
| 41. |                     |            |                        |                                    |               |
| 42. |                     |            |                        |                                    |               |



| Nr. | Emri dhe Mbiemri | Vendbanimi | Telefoni | E-mail | Nënshkrimi |
|-----|------------------|------------|----------|--------|------------|
| 43. |                  |            |          |        |            |
| 44. |                  |            |          |        |            |
| 45. |                  |            |          |        |            |
| 46. |                  |            |          |        |            |
| 47. |                  |            |          |        |            |
| 48. |                  |            |          |        |            |
| 49. |                  |            |          |        |            |
| 50. |                  |            |          |        |            |
| 51. |                  |            |          |        |            |
| 52. |                  |            |          |        |            |
| 53. |                  |            |          |        |            |
| 54. |                  |            |          |        |            |
| 55. |                  |            |          |        |            |
| 56. |                  |            |          |        |            |
| 57. |                  |            |          |        |            |
| 58. |                  |            |          |        |            |
| 59. |                  |            |          |        |            |
| 60. |                  |            |          |        |            |
| 61. |                  |            |          |        |            |
| 62. |                  |            |          |        |            |
| 63. |                  |            |          |        |            |
| 64. |                  |            |          |        |            |
| 65. |                  |            |          |        |            |
| 66. |                  |            |          |        |            |
| 67. |                  |            |          |        |            |
| 68. |                  |            |          |        |            |